



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 4600/prot.
1

Tiranë, më 24.10 2019

VENDIM

Nr. 44, datë 24.10, 2019

Për miratimin e ndryshimeve deri në masën 20%, të planeve mësimore të programeve të studimit, në Institutin e Studimeve Evropiane, të UT-së, për vitin akademik 2019-2020

Bazuar në ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 3, pika 2, gërma “b”; neni 35, pika 9; neni 38, pika 1, gërma “dh”; Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 31, gërma g; si dhe në propozimin e përcjellë nga Instituti i Studimeve Evropiane me shkresën Nr. 246 Prot., datë 14.10.2019, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e datës 24.10.2019;

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Institutit të Studimeve Evropiane për ndryshime, deri në masën 20%, në planet mësimore të programeve të studimit, që ofrohen nga ky institut, për vitin akademik 2019-2020, në:
 - Politika dhe Qeverisja në Europë
 - Legjislacion dhe Institucionet Evropiane
 - Diplomacia dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare të Bashkimit Evropian
2. Ky vendim i përcillet për njoftim Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI
PROF. DR. MYNYR KONI

